



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) e ndërlidhur me nenet 5 shkronja b) dhe 14 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, neneve 6 paragrafi 1.1 dhe 14 paragrafi 3 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, neni 3 paragrafi 1.2, neni 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 17 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2019, Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më datë 27.06.2024, miratoi këtë;

VENDIM

PËR MIRATIM PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Miratohet vendimi paraprak për dhënie në shfrytëzim afat shkurt personave fizikë dhe juridik - Njësia kadastrale P-425-1 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Zakut me sipërfaqe prej 133555 m² në vendin e quajtur "Bellasicë" me shfrytëzim aktual arë e klasës së shtatë (7) me destinim sipas Hartës Zonale, zonë bujqësore e evidentuara në çertifikatën pronësore 08-942/06-0036766/24 të datës 06.06.2024 dhe kopjës së planit, si dhe dokumentacionit përkatës bashkëngjitur këtij vendimi.

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në nenin 1 të këtij vendimi, është shfrytëzimi për qëllime afariste, krijim i mundësive për vende të reja të punës dhe rritje e të hyrave vetanake.

Neni 3

Afati kohor për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në nenin 1 sipas këtij propozim vendimi është afatshkurtër përkatësisht në periudhë 10 (dhjetë) vite.

Neni 4

Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtë realizohet përmes ankandit publik të cilat zbatohen nga Komisioni përkatës vlerësues i cili ngritët nga Kuvendi i Komunës.

Neni 5

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe të përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim, do të rregullohen me kontratë të veçantë, të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi, pas përfundimit të procedurave përkatëse ligjore.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi dhe procedurave përkatëse ligjore dhe nënligjore, kujdeset Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës i cili formohet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqe zyrtare të Komunës., përkatësisht konform nenin 81 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe nenin 90 paragrafi 8 të rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëra me rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot.01-463/06-0041861/24
Podujevë datë, 27.06.2024

Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha





Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71712034-00425-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

08-942/06-0036766/24

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

06.06.2024 - 09:49

Komuna / Opština / Municipality:

PODUEJEVË / PODUJEVO / PODUJEVË

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Zakut / Zakut / Zakut

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

PODUEJEVË / PODUJEVO / PODUJEVË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronise Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përkrahim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-71712034-00425-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		133555			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
BELLASICË-BELLASICË				



A.2 LLOJII I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broy Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenuto koriscenja parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kualitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Povërshina (m ²) Area (m ²)
1	Bujqësore/Poljoprovredno/Agriculture	Ara/Njive/Arable	Arë E Klases 7/Njiva 7 Klase/7th Class Arable Land	133555

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Liceni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo inovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Podujevës	600534946	PODUEVË / PODUEVO / PODUEVË /		NUHI GASHI	1/1		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : **PODUJEVË**

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: **Zakut**

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71712034-00425-0		



Shkalla/Razmera/Scale: 1:4232

Punoi/Obradio/Created: Labinot

Nënshkrimi/Potpis/Signature: 

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 10.06.2024

Koha/ Vreme/ Time: 01:49:46